

WATERSTOP RX101

Parandalues uji hidrofilik ne permbajtje bentoniti

PËRSHKRIMI:

Waterstop RX101 është një parandalues uji me baze bentonit natriumi ,I krijuar për të ndaluar depertimin e ujit tek xhuntot e trukturave te betonit ,i cili zgjerohet ne kontakt me ujin, per te formuar nje lloj mbrojtjeje pozitive perkundrejt filtrimeve te ujit ne beton.Celesi I efektivitetit te Waterstop RX101 qendron te permbajtja me 75 % bentonit natriumi,e cila siguron nje perhapje te gjere te saj per te ngjitur dhe per te mbushur boshlleqet dhe plasaritjet ne beton. Waterstop RX101 eshte nje bentonit aktiv I bazuar ne parandalimin e ujit ,dhe I projektuar per te zevendesuar sitemet jo active sic jane waterstopet prej gome/PVC ,duke eliminuar kerkesen e pjeseve te vecanta dhe procedurat delicate te saldimeve. Waterstop RX101 eshte testuar ne menyre te sukseshme nga subjekte te pavaruara te testimi në mbi 70 m te presionit te ujit hidrostatik, nepermjet zhytjeve te vazhdueshme dhe cilkit te lagesht/te thate.

Waterstop RX 101 ,eshte prodhuar me fleksibilitet te larte per tu pershtatur siperfaqeve ku do te aplikohet ,instalohen lehtesisht nga nje punetor i vetem.Ky produkt vendoset ne siperfaqe betoni, celiku dhe Pvc(tubacione) fiksohet me gozhd dhe rrjete metalike (Revofix Mesh)dhe me ngjitese RX WB .Pjeset e fundit te shiritit nuk duhet te mbivendosen por vetem te perputhen kok me koke per te formuar nje vazhdueshmeri te waterstopit .

APLIKIMET:

Aplikimet perfshijne te gjitha format e shkeputjeve qe krijohen gjate betonive horizontale dhe vertikale me perjashtim te fugave strukturale,bashkime I nje betoni ekzistues me nje betonim te ri dhe depertimet rreth murit ose mespermes tij si pajisjet hidraulike dhe tubacionet. Waterstop RX101 punon si ne kushte ku presioni hidrostatike eshte I perhershem ashtu dhe ne kushte ku ka ndryshime te presionit hidrostatike.

Waterstop RX101 eshte krijuar per tu perdorur ne muret e strukturave beton –arme tipik ne bashkimet pllak-mur midis dy rrjeshtave te hekurit per mure me nje trashesi minimale prej 175mm, dhe duke e mbeshtjelle Rx me jo me pak se 75mm beton nga te gjitha anet.

INSTALIMI

Pergatitja e siperfaqes

Siperfaqet e xhuntove te betonit duhet te jene te pastra dhe pa presence uji statik .Forma e parregullta qe mund te kete betoni duhet te eleminohen per te beret te mundur realizimin e nje siperfaqeje sa me te rregullt qe waterstopi te mbeshtet plotesisht ne beton.Nuk kerkohet krijimi I formave te vecanta ne beton per vendosjen e Waterstopit RX 101

Instalimi I waterstop RX101 me Revofix Mesh

Pas pergatitjes se siperfaqes se betonit , hiqet nga mbeshtjellesja Waterstop Rx101 duke e lene te lire dhe te pademtuar letren ;vendoset mbi beton ne menyre te tille qe letra te jete nga siper ngjishet me kujdes pa e demtuar dhe duke ju pershtatur siperfaqes se betonit pa lene boshlliqe midis Waterstopit dhe betonit.Hiqet letra mbrojtese vendoset rrjeta metalike “REVIFIX MESH “ dhe fiksohet me gozhd(qe gjenden ne konfeksionin e Revofix Mesh).Fiksimi me gozhd duhet mesatarisht cdo 300 mm.Bahkimi I waterstopit ku mbaron shiritit duhet te vendoset keke me koke pa lene hapësire midis tyre dhe per te krijuar vazhdimesi waterstopit.

Xhuntimet e waterstopit krijojne disa shenja te thjeshta.Vazhdueshmeria eshte e sigurt nga ekspandimi I te dy skajeve te waterstopit dhe nepermjet rrjetes metalike Revofix Mesh duke u fiksuar fort ne skajet se bashku me waterstopin.Xhuntimet e rrjetes metalike Revofix Mesh nuk duhet te behen me shkelje por njelloj si ato te waterstopit koke me koke, por eshte shume e rendesishme qe te fiksohet ne menyre perfekte.

Instalimi I RX101 me WB Adhesive(ngjites)

Pas pergatitjes dhe pastrimit te siperfaqes se betonit, mbi te vendoset nje rrip i holle uniform 25mm i gjere me ngjitesin WB mbi beton,duke u pershtatur mire edhe me valezimet e betonit,dhe duhet te aplikohet Rx (per 5-20 min ,ne varesi te temperaturave te ambientit). Tek zonat e aplikuar njhere , ky proces perseritet perseri pas 6 oreve. Vendoset RX, me pjesen e letres nga larte ne menyre te tille ngjitet ne beton pjesa me ngjyre te zeze.duke e ngjeshur me dore per tju pershtatur siperfaqes se betonit . Letra e lirshme mund te lihet, duke e mbrojtur RX nga rreshjet, por DUHET te hiqet para se te Betonohet.

Xhuntimet e Waterstop RX101 jane te njejta si ato te instalimit te WRX101 Me Revofix Mesh.

Waterstop RX101 mund te instalohet edhe perreth tubazioneve qe vendosen ne pllak ose qe depertojne murin e betonit “flanaxha” te hedhura rreth murit ose pllakes per te depertuar mespermes tyre, duke perdorr ngjitesin RX WB ose tel te holle.

Ne siperfaqet e parregullta, duhet te sigurohemi qe waterstop RX101 te jete ne kontakt te drejtperdrejte me kete siperfaqe pergjate gjithë instalimit ne siperfaqen e crregullt, p.sh : xhuntimi I nje siperfaqeje ekzistuese me beton te parregullt qe munde te kete siperfaqja ekzistuese mune te rregullohen me Bentoseal (siguron nje barriere te perhereshme kunder ujit duke e rritur volimin ne kontakt me ujin) aplikimi I Waterstop RX 101 dhe I rrjetes metalike Revofix Mesh me gozhd garanton plotesisht mos depertimin e ujit ne xhuntot e betonit.

KUFIZIMET:

WATERSTOP RX101 nuk eshte nje produkt vetengjites. Revofix Mesh ose ngjitesi WB eshte I nevojshem për të siguruar RX101 ne siperfaqe betoni , metali apo PVC (tubacione).

Waterstop RX101 nuk është I pershtateshem per tu perdeorur ne fugat strukturale (expansion joint) Ju lutemi te kontaktoni me prodhuesin per keto raste.

Waterstop RX101 është projektuar për tu përdorur në struktura betoni. Waterstop RX101 kërkon një minimum prej 75 mm beton për të mbuluar nga të gjitha anët. Waterstop RX101 duhet të përdoret vetëm në rastet kur produkti është plotësisht i mbuluar nga betoni.

Waterstop RX101 nuk duhet të parahidratohet duke u vendosur në sipërfaqe të mbuluara me ujë ose të mbetet në kontakt me ujë para se të aplikohet betoni. Nëse produkti RX 101 blyshet në mënyrë të konsiderueshme para se të mbulohet nga betoni atëherë ai duhet të zëvendësohet.

Në kushtet kur ujërat në tokësor janë me ndotje kimike ose me përmbajtje të lartë kripe, ju lutemi të kontaktoni me prodhuesin për informacione mbi pajtueshmërinë dhe për miratim të përdorimit.

PAKETIMI:

Waterstop RX101 është i paketuar në 5m spirale, 30 ml për kuti, paleta me 720 ml. Revofix Mesh është i paketuar me 30 copë nga 1 m të gjata. Ngjitesia RX WB Adhesive është i paketuar me tubet 3.8 litër (i mjaftueshëm për 100 ml aplikim RX101).

Text on first page :

Waterstop RX 101 është me përmbajtje bentonite natriumi për ndalimin e filtrimeve të ujit në pikat e bashkimeve të betonit.